



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1060/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Dr.sc.Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Alush Shala, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas shpalljes së rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Alush Shala, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me shenjë ZL.An.1060/2017 e datës 13.11.2017, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 përmes dërgesës postare ka pranuar një apel nga Alush Shala, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, i njejtë i protokolluar me datë 13.11.2017 ku pretendohet se në Qendrat e Votimit QVnr. 2002A, 2006A, 2023A, 2025, 2032, 2039, 2047, 2042A, 2005A, 22019A, 20242026, janë bërë pa rregullsi lidhur me numërimin e votave .

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të shkresave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara pasi që parashtruesi i apelit nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe sa pretendon se i posedon.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në Qendrat e Votimit QV nr. 2002A, 2006A, 2023A, 2025, 2032, 2039, 2047,

2042A, 2005A, 22019A, 20242026 të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për apeluesin.

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika (c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, e refuzoj si të pabazuar apelin e apeluesit .


Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1060/2017 më datën 13.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Dr.sc. Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*